



C. nr.66/2010

**GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ,ne qeshtjen juridike te paditesit; nga Mitrovica Rr. , kunder te paditures ; Komuna e Mitrovices- Drejtoria Komunale e Aresimit, baza e kontestit; kompenzimin e pagave nga marrdhenja e punes, vlera e kontestit 1.528,24 euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.26.04.2011 , bie kete.

**AKTGJYKIM**

**APROVOHET** kerkespadia e paditesit; nga Mitrovica dhe **OBLIGOHET** e paditura; Komuna e Mitrovices- Drejtoria Komunale e arsimit, qe ne emer te pagave mujore nga mardheneja e punes ti paguaj paditesit per 7 muaj dhe ate nga muaj, Shtator 2008, gjere ne Mars 2009, shumen prej 1.528,24 Euro, ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Obligohet e paditura qe paditesit te ia kompenzoi shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 40,00 euro, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.


**Arsyetim**

Paditesi ne padin e parashtuar ,precizimin e saje si dhe ne scancat e mbajtura ka theksuar; me te padituren kane lidhur kontrate pune per vendin e punes si mesimdhenes per lenden e Fizikes ne Shkollen e Mesme te Larte teknike-Artitekt Sinani- ne Mitrovice. Kontrata eshte lidhur per periudhen 1 vjeqare, 01.09.2008 qjer 31.08.2009.

Per periudhen e kontraktuar nga e paditura nuk eshte kompenzuar plotesisht per punen e kryer ne baze te kntrates, por ka marr pagat vetem per muajt; Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht 2009. Ndersa nuk i kane kompenzuar pagat per muajt, Shtator 2008 gjer Mars 2009, ne shume te tersishme prej 1.528,24 Euro.

Paditesi ka ber kerkes te paditures per permbushjen e kontrates mirepo pa suksese, keshtu i propozon gjukates qe padin dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar. Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoj.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te perfaqsesit te te paditures, konform nen.423.4 te LPK.



Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Kontraten e punes te dt.18.03.2009, Kerkesen e paditesit drejtuar te paditures te dt. 13.11.2009, Ankesen e paditesit drejtuar te paditures

dt.15.02.2010, Vertetimin e Shkolles se Mesme Teknike Artitekt Sinani ne Mitrovice dt.28.02.2011,si dhe transaksionet bankare te Pro Credit Bankes dt. 03.11. 2009 dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga Kontrata e punes e cekur me larte konstatohet se Paditesi me te padituren kane lidhur Kontrat pune per mesimdhenes per vendin e punes si mesimdhanes per lenden e Fizikes ne Shkollen e Mesme te Larte Teknike -Arkitekt Sinani ne Mitrovice per periudhen 1 vjeqare,01.09.2008 gjer 31.08.2009; me ore pune ne jave 40, ore mesimi ne jave 21. me page mujore te pa caktuar.

Nga kerkesa e paditesit drejtuar te paditures te cekur me larte, konstatohet se paditesi me dt.13. 11. 2009 i eshte drejtuar te paditures per permbushjen e kontrates se punes, qe t i paguhen pagat per periudhen Shtator 2008 gjer ne Maj 2009.

Nga ankesa e dt 15.02.2010, konstatohet se paditesi i eshte drejtuar Bordit te ankesave pran te paditures, per pagesen e pagave ta pa kompenzuara per periudhen e cekur me larte.

Nga vertetimi i Shkolles se Mesme Teknike- Artitekt Sinani te cekur me larte, konstatohet se paditesi ka punuar ne kete shkolle ne vendin e punes- Profesor nga dt. 15.09.2007 gjer 31.08.2008 dhe nga dt. 01.04. 2009 gjer 31.08.2009.

Nga transaksionet bankare te Pro Credit Bnkes, ne Mitrovice , konstatohet se ne emer te me 29.06.2009, me 30.07.,2009, me 31.08.2009 eshte ber pagesa ne shume prej nga 218,32 euro dhe me dt.01.10.2009, shuma prej 423,98 euro.

Ne nje gjendje te ketille faktike -nga provat e cekura me larte , rrjedhe se; Kontrata e punes eshte e lidhur ne formen dhe permbajtjen e parapar ne kuptim te nen. 10 dhe 11. te Ligjit i punes Nr.03/2-212.

Konform nen 55 pika 1 dhe 6 te Ligjit te punes eshte percaktuar; I punesuari ka te drejt ne page e cila percaktohet me kontraten e punes, ne pajtim me ket ligj, Kontraten kolektive, Aktin e brendshem te punedhenesit dhe se paga paguhet me se paku 1 her ne muaj.

Ne rastin konkret kemi te bejme me pune te kontraktuar dhe percaktuar ne afat prej 01.09.2008 gjer 31.08.2009., ku lende e kontrates eshte puna- kryrja e punes se caktuar, pra kemi nje marrdhenje-juridike midis paditesit dhe te paditures me te cilen paditesi eshte i obliguar qe ta kryeje punen e caktuar siq eshte caktuar ne kontraten e punes te cekur me larte, kurse e paditura detyrohet qe per kete paditesit, ti paguaj shperblimin e caktuar e ter kjo konform nen. 600 te Ligjit mbi marrdhenjet detyrimore.

Gjykata duke u nisur nga Kontrata e punes e cekur me larte dhe faktit se e paditura edhepse eshte ftuar rregullisht per seanca por nuk prezentoj dhe se nuk ka kontestuar kerkespadin me ane te parashtrases, gjykata konkludon se paditesi ka punuar ne periudhen kontestuese dhe se nuk i jane paguar te ardhurat personale per kete periudhe, prandaj vendosi si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazohet konform nen, 452.1 te LPK, duke i njohur paditesit shpenzimet dhe at; ne emer te taksave per padi dhe aktgjykim, shume prej 40,00 euro, konform nen.10.1 Tarifes mbi taksat gjyqsore .

Nga si u tha me larte u vendose si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE**  
**C. nr. 66/2010 dt 26.04.2011**



**KESHILLE JURIDIKE,** Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve , nga dita e pranimit Gjykates se Qarkut ne Mitrovice e nepermjet te kesaje gjykate.

*Te egi:*  
*1 - Padituesit*  
*1 - Prokurues: Aneta Paditues Komand*  
*Mirë*

*T = 24*